

# Mënyra e regjistrimit në Platformën Online dhe në Praktikën Profesionale.

**Në fillim duhet të krijoni llogarinë tuaj në Platformën Online.**

Duhet të klikoni ne Google dhe të shkruani [app-uish.org](http://app-uish.org) dhe do t'ju shfaqet Platforma Digjitale Online.

- Do shkoni tek opsioni Anëtarësohu që të krijoni profilin tuaj në Platformë.
- Pasi të klikoni tek Anëtarësohu do t'ju kërkohen të dhënat tuaja duke plotësuar të gjitha fushat e detyrueshme.

• Vendosni emailin tuaj që keni aktiv të cilin e përdorni dhe më pas fjalëkalimin me 8 ose më shumë karaktere ku duhet të ketë shkronjë të madhe, shkronjë të vogël dhe numra.

Kujdes: Fjalëkalimi që do krijoni duhet të jetë i ndryshëm nga ai që keni në email.

• Plotësoni të dhënat tuaja të sakta sipas fushave që ju kërkohen: emër, mbiemër, atësinë, mbiemrin e vajzërisë ( është opsionale), datëlindjen, gjininë, nr e Kartës tuaj të Identitetit (duhet të vendosni nr. që fillon dhe mbaron me shkronjë psh.X00000000Y), nr. e telefonit ku të fillojë me +355... , vendlindjen, vendbanimin, qarkun tuaj, kombësinë dhe shtetësinë.

• Duke klikuar tek fusha “ID ose Pasaporta” do ngarkoni Kartën tuaj të Identitetit ose Pasaportën ,në formatin pdf.

• Duke klikuar tek fusha “Fotografia” do ngarkoni Foto Dokumenti ( me veshje serioze, pasi kjo foto do të vendoset automatikisht në Licensën tuaj kur ju të licencoheni)

• Kliko opsionin “Konfirmoj Deklaratën” për të vazhduar më tej me procedurat e radhës.

• Do plotësoni të dhënat e shkollimit tuaj duke klikuar në fushat përkatëse: Emri i institucionit arsimor, nr. e diplomës, datën e diplomimit, nivelin e shkollimit, qytetin ku keni kryer studimet, shtetin ku jeni diplomuar si dhe pofesionin tuaj.

• Ngarkoni diplomën(në mungesë të diplomës vërtetim diplomimi) dhe listen e notave të noterizuara si dhe cv-në duke klikuar në fushat përkatëse. Dokumentat duhet të jenë në formatin pdf, ndryshe aplikimi juaj nuk ka rezultat.

• Pas plotësimit të të gjitha fushave kontrolloni dhe njëherë nëse të gjitha fushat e detyrueshme janë të plotësuara dhe pasi ta keni bërë këtë jepni komandën Vazhdo.

Në këtë moment krijohet profili juaj në Platformën digjitale online, ku do të keni dhe nje mesazh mirëseardhjeje në email dhe në Platformë.

.

## Procedura për Regjistrim në Praktikën Profesionale.

- Pasi keni krijuar profilin tuaj dhe jeni tashmë anëtar në Platformën digjitale, shkoni tek rubrika “Praktika” dhe klikoni aty.
- Plotësoni profesionin për të cilin do të regjistroheni për ndjekjen e praktikës profesionale 3 mujore.

Gjithashtu dhe shkollimin tuaj të cilin e merr automatikisht sistemi.

- Në emailin tuaj vjen fatura e aplikimit për praktikën profesionale të cilën duhet ta printoni për ta paguar në banke dhe më pas ta ngarkoni në rubrikën “Ngarko pagesën”, mandatin që ju jep banka.
- Pasi të keni ngarkuar faturën do t’ju vij një njoftim në Platformë që fatura juaj është ngarkuar me sukses dhe do qëndroni në pritje të shqyrtimit të aplikimit.

Kur të shqyrtohet aplikimi do te njoftoheni nëpërmjet Platformës Online për datën e fillimit dhe të përfundimit të praktikës profesionale, institucionin ku do të zhvilloni praktikën si dhe drejtuesin e praktikës.